



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.130/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Malishevë për shkak të vendosjes së flamujve në shtylla elektrike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.130/2017 e dates 07.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli Prishtinë

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017 në rrugën “Avdyl Krasniqi” në Malishevë, aktivisti i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla elektrike ishin vendosur flamujt të Koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA thekson se në momentin që kanë pranuar Urdhërin për Përmirësim kanë kontaktuar me shtabin zgjedhor në komunën e Malishevës për të bërë heqjen e posterit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që materiali zgjedhor-flamujt e koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë të vendosur pikërisht në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të flamujve.

Paneli gjatë shqyrtimit të ankesës mori për bazë pretendimet e theksuara në përgjigje në ankesë nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, se vendosja e posterave apo materialeve zgjedhore në shtylla elektrike nuk është e ndaluar si në rastin konkret .

Mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë nuk ka kryer shkelje të neni 33 pika (b) të LZP-së dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.130/2017 më datën 09.06.2017



Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.